

LIGJ
Nr. 67/2025

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN E
MARRAKESHIT PËR LEHTËSIMIN E AKSESIT NË VEPRAT E BOTUARA PËR
PERSONAT E VERBËR, ME VËSHTIRËSI NË SHIKIM OSE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË LEXIMIN E TEKSTEVE TË SHTYPURA, BËRË NË MARRAKESH,
MË 27.6.2013**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e Marrakeshit për lehtësimin e aksesit në veprat e botuara për personat e verbër, me vështirësi në shikim ose me aftësi të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, bërë në Marrakesh, më 27.6.2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2025

**Shpallur me dekreten nr. 498, datë 19.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**TRAKTATI I MARRAKESHIT PËR LEHTËSIMIN E AKSESIT NË VEPRAT E
BOTUARA PËR PERSONAT E VERBËR, ME VËSHTIRËSI NË SHIKIM OSE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA NË LEXIMIN E TEKSTEVE TË SHTYPURA^{*1}**

PËRMBAJTJA

Preambula

Neni 1: Lidhja me Konventat dhe Traktatet e Tjera

Neni 2: Përkufizime

Neni 3: Personat përfitues

Neni 4: Kufizimet dhe përjashtimet e ligjit kombëtar lidhur me kopjet në format të aksesueshëm

Neni 5: Shkëmbimi ndërkufitar i kopjeve në format të aksesueshëm

Neni 6: Importimi i kopjeve në format të aksesueshëm

Neni 7: Detyrimet lidhur me masat teknologjike

Neni 8: Respekti për privatësinë

Neni 9: Bashkëpunimi për të lehtësuar shkëmbimin ndërkufitar

Neni 10: Parimet e përgjithshme mbi zbatimin

Neni 11: Detyrimet e përgjithshme mbi kufizimet dhe përjashtimet

Neni 12: Kufizime dhe përjashtime të tjera

Neni 13: Asambleja

¹ Ky Traktat u miratua nga Konferenca Diplomatike për të lidhur një Traktat për të lehtësuar aksesin në veprat e botuara nga personat me vështirësi në shikim dhe personat me vështirësi në leximin e teksteve të shtypura, më 27 qershor 2013.

Neni 14: Byroja Ndërkombëtare
Neni 15: E drejta për t'u bërë palë në Traktat
Neni 16: Të drejtat dhe detyrimet sipas Traktatit
Neni 17: Nënshkrimi i Traktatit
Neni 18: Hyrja në fuqi e Traktatit
Neni 19: Data e hyrjes në fuqi të anëtarësimit në Traktat
Neni 20: Denoncimi i Traktatit
Neni 21: Gjuhët e Traktatit
Neni 22: Depozitari

Preambula

Palët Kontraktuese,

duke kujtuar parimet e mosdiskriminimit, mundësive të barabarta, aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes, dhe përfshirjes së plotë dhe efektive në shoqëri, të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

të vëmendshëm ndaj sfidave që dëmtojnë zhvillimin e plotë të personave me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, të cilat kufizojnë lirinë e tyre të shprehjes, duke përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacione dhe ide të të gjitha llojeve mbi baza të barabarta me të tjerët, duke përfshirë edhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre, gëzimin e së drejtës së tyre për arsim dhe mundësinë për të kryer kërkime;

duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës së autorit si stimul dhe shpërblim për krijimet letrare dhe artistike dhe për rritjen e mundësive për të gjithë, duke përfshirë personat me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit, për të shijuar artet dhe për të ndarë progresin shkencor dhe përfitimet e tij;

të vetëdijshëm për pengesat e personave me dëmtime të shikimit ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura për të aksesuar veprat e botuara në arritjen e mundësive të barabarta në shoqëri, si dhe nevojën për të zgjeruar numrin e veprave në formate të aksesueshme dhe për të përmirësuar qarkullimin e veprave të tilla;

duke marrë parasysh se shumica e personave me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, jetojnë në vende në zhvillim dhe më pak të zhvilluara;

duke pranuar se pavarësisht ndryshimeve në ligjet kombëtare të të drejtave të autorit, ndikimi pozitiv i teknologjive të reja të informacionit dhe i komunikimit në jetën e personave me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura mund të përforcohet nga një kuadër ligjor i përmirësuar në nivel ndërkombëtar;

duke pranuar se shumë Shtete Anëtare kanë vendosur kufizime dhe përjashtime në ligjet e tyre kombëtare të të drejtave të autorit për personat me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, megjithatë ekziston një mungesë e vazhdueshme e veprave të disponueshme në kopje në format të aksesueshëm për persona të tillë, dhe se kërkohen burime të konsiderueshme për përpjekjet e tyre për t'i bërë veprat të aksesueshme për këta persona, dhe se mungesa e mundësive të shkëmbimit ndërkufitar të kopjeve në format të aksesueshëm ka bërë të nevojshëm dyfishimin e këtyre përpjekjeve;

duke pranuar si rëndësinë e rolit të mbajtësve të të drejtave në bërjen e veprave të tyre të aksesueshme për personat me dëmtime të shikimit ose me aftësi të tjera kufizuara në leximin e teksteve të shtypura, ashtu edhe rëndësinë e kufizimeve dhe të përjashtimeve të përshtatshme për t'i bërë veprat të aksesueshme për këta persona, veçanërisht kur tregu nuk mund të ofrojë një akses të tillë;

duke pranuar nevojën për të ruajtur një ekuilibër midis mbrojtjes efektive të të drejtave të autorëve dhe interesit më të gjerë publik, veçanërisht arsimit, kërkimit dhe aksesit në informacion, dhe se një ekuilibër i tillë duhet të lehtësojë aksesin efektiv dhe në kohë në vepra në interes të personave me dëmtime në shikim ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura;

duke riafirmuar detyrimet e Palëve Kontraktuese sipas traktateve ndërkombëtare ekzistuese mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe rëndësinë dhe fleksibilitetin e testit me tre hapa për kufizimet dhe përjashtimet e përcaktuara në nenin 9(2) të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare;

duke kujtuar rëndësinë e rekomandimeve të Agjendës së Zhvillimit, të miratuara në vitin 2007 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale (WIPO), të cilat synojnë të garantojnë që konsideratat e zhvillimit të jenë pjesë integrale e punës së Organizatës;

duke njohur rëndësinë e sistemit ndërkombëtar të të drejtave të autorit dhe duke dëshiruar të harmonizojnë kufizimet dhe përjashtimet, me qëllim lehtësimin e aksesit dhe përdorimit të veprave nga personat me dëmtime të shikimit ose me aftësi të tjera të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Lidhja me Konventat dhe Traktatet e Tjera

Asgjë në këtë Traktat nuk do të cenojë asnjë detyrim që Palët Kontraktuese kanë ndaj njëra-tjetrës sipas ndonjë traktati tjetër, as nuk do të cenojë ndonjë të drejtë që një Palë Kontraktuese ka sipas ndonjë traktati tjetër.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij Traktati:

a) “Vepra” do të thotë vepra letrare dhe artistike sipas kuptimit të nenit 2(1) të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, në formën e tekstit, shënimeve dhe/ose ilustrimeve përkatëse, pavarësisht nëse janë botuar ose janë bërë të disponueshme publikisht në ndonjë media.²

b) “Kopje në format të aksesueshëm” do të thotë një kopje e një vepre në mënyrë, ose formë alternative, që i jep një personi përfitues akses në vepër, duke përfshirë edhe lejimin e personit për të pasur akses po aq të mundshëm dhe komod sa një person pa dëmtime të shikimit, ose paaftësi të tjera në leximin e teksteve të shtypura. Kopja në format të aksesueshëm përdoret ekskluzivisht nga personat përfitues dhe duhet të respektojë integritetin e veprës origjinale, duke marrë parasysh ndryshimet e nevojshme për ta bërë veprën të aksesueshme në formatin alternativ dhe nevojat e aksesueshmërisë së personave përfitues.

c) “Subjekt i autorizuar” do të thotë një subjekt që është i autorizuar, ose i njohur nga qeveria për të ofruar arsim, trajnim mësimor, lexim adaptiv ose akses në informacion për personat përfitues mbi baza jofitimprurëse. Ai përfshin, gjithashtu, një institucion qeveritar ose organizatë jofitimprurëse që ofron të njëjtat shërbime për personat përfitues, si një nga aktivitetet e saj kryesore ose detyrimet institucionale.³

Një subjekt i autorizuar përcakton dhe ndjek praktikën e veta:

- i. për të përcaktuar se personat të cilëve u shërben janë persona përfitues;
- ii. për të kufizuar shpërndarjen dhe vënien në dispozicion të kopjeve në format të aksesueshëm vetëm për personat përfitues dhe/ose subjektet e autorizuara;
- iii. për të shkurajuar riprodhimin, shpërndarjen dhe vënien në dispozicion të kopjeve të paautorizuara; dhe

² Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 2(a): për qëllimet e këtij Traktati, kuptohet që ky përkufizim përfshin vepra të tilla në formë audio, siç janë librat audio.

³ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 2(c): për qëllimet e këtij Traktati, kuptohet që “subjektet e njohura nga qeveria” mund të përfshijnë subjekte që marrin mbështetje financiare nga qeveria për të ofruar arsim, trajnim mësimor, lexim adaptiv ose akses në informacion për personat përfitues mbi baza jofitimprurëse.

iv. për të ruajtur kujdesin e duhur dhe për të regjistruar trajtimin e kopjeve të veprave, duke respektuar privatësinë e personave përfitues në përputhje me nenin 8.

Neni 3 **Personat përfitues**

Një person përfitues është një person i cili:

a) është i verbër;

b) ka një dëmtim të shikimit ose aftësi të kufizuara në perceptim ose lexim, e cila nuk mund të përmirësohet për të dhënë funksion vizual kryesisht ekuivalent me atë të një personi që nuk ka dëmtim, ose aftësi të kufizuara, të tillë dhe për këtë arsye nuk mund të lexojë vepra të shtypura kryesisht në të njëjtën shkallë me një person pa dëmtim ose aftësi të kufizuara; ose⁴

c) përndryshe, për shkak të aftësisë së kufizuar fizike, nuk mund të mbajë, ose të manipulojë një libër, ose të përqendrohet ose të lëvizë sytë në masën që do të ishte normalisht e pranueshme për lexim,

pavarësisht nga ndonjë aftësi tjetër e kufizuar.

Neni 4

Kufizimet dhe përjashtimet e ligjit kombëtar në lidhje me kopjet në format të aksesueshëm

1. a) Palët Kontraktuese duhet të parashikojnë në ligjet e tyre kombëtare të të drejtave të autorit, një kufizim ose përjashtim nga e drejta e riprodhimit, e drejta e shpërndarjes dhe e drejta e vënies në dispozicion të publikut, siç parashikohet nga Traktati i të Drejtave të Autorit i WIPO-s (WCT), për të lehtësuar disponueshmërinë e veprave në kopje, në format të aksesueshëm për personat përfitues. Kufizimi ose përjashtimi i parashikuar në ligjin kombëtar duhet të lejojë ndryshimet e nevojshme për ta bërë veprën të aksesueshme në formatin alternativ.

b) Palët Kontraktuese mund të parashikojnë, gjithashtu, një kufizim ose përjashtim nga e drejta e performancës publike për të lehtësuar aksesin në vepra për personat përfitues.

2. Një Palë Kontraktuese mund të përmbushë nenin 4(1) për të gjitha të drejtat e identifikuara në të, duke parashikuar një kufizim ose përjashtim në ligjin e saj kombëtar të të drejtave të autorit, në mënyrë të tillë që:

a) subjekteve të autorizuar do t'u lejohet, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtës së autorit, të bëjnë një kopje në format të aksesueshëm të një veprë, të marrin nga një subjekt tjetër i autorizuar një kopje në format të aksesueshëm dhe t'ua ofrojnë këto kopje personave përfitues me çdo mjet, duke përfshirë huadhënien jokomerciale ose komunikimin elektronik me anë të mjeteve me tel ose pa tel, dhe të ndërmarrin çdo hap të ndërmjetëm për të arritur këta objektiva, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. subjekti i autorizuar që dëshiron të ndërmarrë aktivitetin e lartpërmendur, ka akses të ligjshëm në atë vepër ose në një kopje të asaj veprë;

ii. vepra konvertohet në një kopje në format të aksesueshëm, e cila mund të përfshijë çdo mjet të nevojshëm për të naviguar në informacion në formatin e aksesueshëm, por nuk sjell ndryshime të tjera, përveç atyre të nevojshme për ta bërë veprën të aksesueshme për personin përfitues;

iii. kopje të tilla në format të aksesueshëm ofrohen ekskluzivisht për t'u përdorur nga personat përfitues; dhe

iv. aktiviteti ndërmerret mbi baza jofitimprurëse; dhe

b) një person përfitues ose dikush që vepron në emër të tij ose të saj, duke përfshirë një kujdestar kryesor ose kujdestar, mund të bëjë një kopje në format të aksesueshëm të një veprë për përdorim personal të personit përfitues ose mund ta ndihmojë personin përfitues të bëjë dhe të përdorë kopje në format të aksesueshëm, kur personi përfitues ka akses të ligjshëm në atë vepër, ose në një kopje të asaj veprë.

⁴ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 3(b): asgjë në këtë gjuhë nuk nënkupton që “nuk mund të përmirësohet” kërkon përdorimin e të gjitha procedurave dhe trajtimeve të mundshme diagnostikuese mjekësore.

3. Një Palë Kontraktuese mund të përmbushë nenin 4(1), duke parashikuar kufizime ose përjashtime të tjera në ligjin e saj kombëtar të së drejtës së autorit, në përputhje me nenet 10 dhe 11.⁵

4. Një Palë Kontraktuese mund të kufizojë kufizimet ose përjashtimet sipas këtij neni, për veprat të cilat, në formatin e veçantë të aksesueshëm, nuk mund të merren komercialisht sipas kushteve të arsyeshme për personat përfitues në atë treg. Çdo Palë Kontraktuese që përfiton nga kjo mundësi, duhet ta deklarojë këtë në një njoftim të depozituar te drejtori i përgjithshëm i WIPO-s në kohën e ratifikimit, pranimit ose aderimit në këtë Traktat ose në çdo kohë të mëpasshme.⁶

5. Do të jetë çështje e ligjit kombëtar që të përcaktojë nëse kufizimet ose përjashtimet sipas këtij neni, i nënshtrohen kompensimit.

Neni 5

Shkëmbimi ndërkufitar i kopjeve në format të aksesueshëm

1. Palët Kontraktuese do të parashikojnë që nëse një kopje në format të aksesueshëm bëhet sipas një kufizimi ose përjashtimi, ose në përputhje me zbatimin e ligjit, ajo kopje në format të aksesueshëm mund të shpërndahet, ose të vihet në dispozicion, nga një subjekt i autorizuar për një person përfitues, ose subjekt të autorizuar në një Palë tjetër Kontraktuese.⁷

2. Një Palë Kontraktuese mund të përmbushë nenin 5(1), duke parashikuar një kufizim ose përjashtim në ligjin e saj kombëtar të të drejtave të autorit, në mënyrë të tillë që:

a) Subjekteve të autorizuar do t'u lejohet, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtës, të shpërndajnë ose të vënë në dispozicion për përdorim ekskluziv të personave përfitues kopje në format të aksesueshëm për një subjekt të autorizuar në një Palë tjetër Kontraktuese; dhe

b) Subjekteve të autorizuar do t'u lejohet, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtës dhe në përputhje me nenin 2(c), të shpërndajnë ose të bëjnë të disponueshme kopje në format të aksesueshëm për një person përfitues në një Palë tjetër Kontraktuese,

me kusht që para shpërndarjes ose vënies në dispozicion, subjekti i autorizuar fillestar nuk e dinte ose nuk kishte shkaqe të arsyeshme për të ditur se kopja në format të aksesueshëm do të përdorej për persona të tjerë përveç atyre përfitues⁸.

3. Një Palë Kontraktuese mund të përmbushë nenin 5(1), duke parashikuar kufizime ose përjashtime të tjera në ligjin e saj kombëtar të së drejtës së autorit në përputhje me nenet 5(4), 10 dhe 11.

4. a) Kur një subjekt i autorizuar në një Palë Kontraktuese merr kopje në format të aksesueshëm, në përputhje me nenin 5(1) dhe ajo Palë Kontraktuese nuk ka detyrime sipas nenit 9 të Konventës së Bernës, ajo do të garantojë, në përputhje me sistemin dhe praktikën e veta ligjore, që kopjet në format të aksesueshëm të riprodhohen, shpërndahen, ose të vihen në dispozicion vetëm në interes të personave përfitues në juridiksionin e asaj Pale Kontraktuese.

b) Shpërndarja dhe vënia në dispozicion e kopjeve në format të aksesueshëm nga një subjekt i autorizuar në përputhje me nenin 5(1) do të kufizohet në atë juridiksion, përveç nëse Pala Kontraktuese është Palë e Traktatit të të Drejtave të Autorit të WIPO-s, ose ndryshe kufizon kufizimet dhe përjashtimet që zbatojnë këtë Traktat në të drejtën e shpërndarjes dhe në të drejtën e vënies në dispozicion të publikut, në raste të caktuara të veçanta që nuk bien ndesh me një shfrytëzim normal

⁵ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 4(3): kuptohet që ky paragraf as nuk e redukton, as nuk e zgjeron fushëveprimin e zbatueshmërisë së kufizimeve dhe përjashtimeve të lejuara sipas Konventës së Bernës, në lidhje me të drejtën e përkthimit, në lidhje me personat me dëmtime të shikimit, ose me aftësi të tjera të kufizuara, në leximin e teksteve të shtypura.

⁶ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 4(4): kuptohet që një kërkesë për disponueshmëri komerciale nuk paragjykon nëse një kufizim ose përjashtim sipas këtij neni është në përputhje me testin me tre hapa.

⁷ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 5(1): kuptohet, gjithashtu, se asgjë në këtë Traktat nuk e redukton ose zgjeron fushëveprimin e të drejtave ekskluzive sipas ndonjë traktati tjetër.

⁸ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 5(2): kuptohet që, për të shpërndarë, ose për të vënë në dispozicion kopje në format të aksesueshëm drejtpërdrejt për një person përfitues në një Palë tjetër Kontraktuese, mund të jetë e përshtatshme që një subjekt i autorizuar të zbatojë masa të mëtejshme për të konfirmuar që personi të cilit i shërben është një person përfitues dhe të ndjekë praktikën e veta, siç përshkruhet në nenin 2(c).

të veprës dhe nuk dëmtojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitimë të mbajtësit të së drejtës.⁹

10

c) Asgjë në këtë nen nuk ndikon në përcaktimin e çka përbën një akt shpërndarjeje ose një akt të vënies në dispozicion të publikut.

5. Asgjë në këtë Traktat nuk do të përdoret për të trajtuar çështjen e shterimit të të drejtave.

Neni 6

Importimi i kopjeve në format të aksesueshëm

Në masën që ligji kombëtar i një Pale Kontraktuese do të lejonte një person përfitues, dikë që vepron në emër të tij ose të saj, ose një subjekt të autorizuar, të bënte një kopje në format të aksesueshëm të një veprë, ligji kombëtar i asaj Pale Kontraktuese do t'i lejojë, gjithashtu, që të importojnë një kopje në format të aksesueshëm në interes të personave përfitues, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtave.¹¹

Neni 7

Detyrimet në lidhje me masat teknologjike

Palët Kontraktuese marrin masat e duhura, sipas nevojës, për të garantuar që kur ato ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme ligjore dhe mjete efektive ligjore kundër anashkalimit të masave teknologjike efektive, kjo mbrojtje ligjore të mos i pengojë personat përfitues që të gëzojnë kufizimet dhe përjashtimet e parashikuara në këtë Traktat.¹²

Neni 8

Respektimi i privatësisë

Në zbatimin e kufizimeve dhe të përjashtimeve të parashikuara në këtë Traktat, Palët Kontraktuese do të përpiqen të mbrojnë privatësinë e personave përfitues në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Neni 9

Bashkëpunimi për të lehtësuar shkëmbimin ndërkufitar

1. Palët Kontraktuese do të përpiqen të nxisin shkëmbimin ndërkufitar të kopjeve në format të aksesueshëm, duke inkurajuar ndarjen vullnetare të informacionit për të ndihmuar subjektet e autorizuar në identifikimin e njëri-tjetrit. Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s do të krijojë një pikë aksesimi në informacion për këtë qëllim.

2. Palët Kontraktuese marrin përsipër të ndihmojnë subjektet e tyre të autorizuar të angazhuara në aktivitete, sipas nenit 5, për të vënë në dispozicion informacion në lidhje me praktikën e tyre, në përputhje me nenin 2(c), si nëpërmjet ndarjes së informacionit midis subjekteve të autorizuar, ashtu edhe nëpërmjet vënies në dispozicion të informacionit mbi politikën dhe praktikën e tyre, duke përfshirë shkëmbimin ndërkufitar të kopjeve në format të aksesueshëm, për palët e interesuara dhe anëtarët e publikut, sipas rastit.

⁹ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 5(4)(b): kuptohet që asgjë në këtë Traktat nuk kërkon ose nënkupton që një Palë Kontraktuese të miratojë, ose të zbatojë testin me tre hapa përtej detyrimeve të saj, sipas këtij instrumenti ose sipas traktateve të tjera ndërkombëtare.

¹⁰ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 5(4)(b): kuptohet që asgjë në këtë Traktat nuk krijon detyrime për një Palë Kontraktuese për të ratifikuar ose aderuar në WCT ose për t'u pajtuar me ndonjë nga dispozitat e saj dhe asgjë në këtë Traktat nuk cenon ndonjë të drejtë, kufizim dhe përjashtim në përmbajtje të WCT-së.

¹¹ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 6: kuptohet që Palët Kontraktuese kanë të njëjtat fleksibilitete të përcaktuara në nenin 4, kur zbatojnë detyrimet e tyre sipas nenit 6.

¹² Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 7: kuptohet që subjektet e autorizuar, në rrethana të ndryshme, zgjedhin që të zbatojnë masa teknologjike në krijimin, shpërndarjen dhe vënien në dispozicion të kopjeve në format të aksesueshëm dhe asgjë këtu nuk i shqetëson praktika të tilla, kur janë në përputhje me ligjin kombëtar.

3. Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s ftohet të ndajë informacion, kur është i disponueshëm, në lidhje me funksionimin e këtij Traktati.

4. Palët Kontraktuese njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe nxitjen e tij, në mbështetje të përpjekjeve kombëtare për realizimin e qëllimit dhe objektivave të këtij Traktati.¹³

Neni 10

Parimet e përgjithshme mbi zbatimin

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër të miratojnë masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e këtij Traktati.

2. Asgjë nuk do t'i pengojë Palët Kontraktuese që të përcaktojnë metodën e duhur të zbatimit të dispozitave të këtij Traktati brenda sistemit dhe praktikës së tyre ligjore.¹⁴

3. Palët Kontraktuese mund të përmbushin të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas këtij Traktati nëpërmjet kufizimeve ose përjashtimeve specifike në interes të personave përfitues, kufizimeve ose përjashtimeve të tjera, ose një kombinimi të tyre, brenda sistemit dhe praktikës së tyre ligjore kombëtare. Këto mund të përfshijnë përcaktime/vendime gjyqësore, administrative ose rregullatore në interes të personave përfitues, në lidhje me praktikën, marrëveshjet ose përdorimet e drejta për të përmbushur nevojat e tyre, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, sipas Konventës së Bernës, traktateve të tjera ndërkombëtare dhe nenit 11.

Neni 11

Detyrimet e përgjithshme mbi kufizimet dhe përjashtimet

Në miratimin e masave të nevojshme për të garantuar zbatimin e këtij Traktati, një Palë Kontraktuese mund të ushtrojë të drejtat dhe duhet të përmbushë detyrimet që ajo Palë Kontraktuese ka sipas Konventës së Bernës, Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe Traktatit të të Drejtave të Autorit të WIPO-s, duke përfshirë marrëveshjet e tyre interpretuese në mënyrë që:

a) në përputhje me nenin 9(2) të Konventës së Bernës, një Palë Kontraktuese mund të lejojë riprodhimin e veprave në raste të caktuara të veçanta, me kusht që një riprodhim i tillë të mos bjerë ndesh me shfrytëzimin normal të veprës dhe të mos dëmtojë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitimë të autorit;

b) Në përputhje me nenin 13 të Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, një Palë Kontraktuese do të kufizojë kufizimet ose përjashtimet e të drejtave ekskluzive, në raste të caktuara të veçanta, që nuk bien ndesh me shfrytëzimin normal të veprës dhe nuk dëmtojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitimë të mbajtësit të së drejtës;

c) Në përputhje me nenin 10(1) të Traktatit të të Drejtave të Autorit të WIPO-s, një Palë Kontraktuese mund të parashikojë kufizime ose përjashtime nga të drejtat e dhëna autorëve, sipas WCT-së, në raste të caktuara të veçanta, të cilat nuk bien ndesh me shfrytëzimin normal të veprës dhe nuk dëmtojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitimë të autorit;

d) Në përputhje me nenin 10(2) të Traktatit të të Drejtave të Autorit të WIPO-s, një Palë Kontraktuese, kur zbaton Konventën e Bernës, do të kufizojë çdo kufizim ose përjashtim nga të drejtat, në raste të caktuara të veçanta që nuk bien ndesh me një shfrytëzim normal të veprës dhe nuk dëmtojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitimë të autorit.

¹³ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 9: kuptohet që neni 9 nuk nënkupton regjistrim të detyrueshëm për subjektet e autorizuar dhe as nuk përbën parakusht që subjektet e autorizuar të angazhohen në aktivitete të njohura sipas këtij Traktati; por ai parashikon një mundësi për ndarjen e informacionit për të lehtësuar shkëmbimin ndërkufitar të kopjeve në format të aksesueshëm.

¹⁴ Deklaratë e dakordësuar në lidhje me nenin 10(2): Kuptohet që kur një vepër kualifikohet si vepër sipas nenit 2(a), duke përfshirë vepra të tilla në formë audio, kufizimet dhe përjashtimet e parashikuara nga ky Traktat zbatohen *mutatis mutandis* për të drejtat e lidhura sipas nevojës për të bërë kopjen në format të aksesueshëm, për ta shpërndarë dhe bërë atë të disponueshme për personin përfitues.

Neni 12

Kufizime dhe përjashtime të tjera

1. Palët Kontraktuese pranojnë që një Palë Kontraktuese mund të zbatojë në ligjin e saj kombëtar kufizime dhe përjashtime të tjera të së drejtës së autorit në interes të personave përfitues, sesa ato të parashikuara nga ky Traktat, duke pasur parasysh situatën ekonomike të asaj Pale Kontraktuese dhe nevojat e saj sociale dhe kulturore, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare të asaj Pale Kontraktuese, dhe në rastin e një vendi më pak të zhvilluar, duke marrë parasysh nevojat e tij të veçanta dhe të drejtat dhe detyrimet e tij të veçanta ndërkombëtare dhe fleksibilitetet e tyre.

2. Ky Traktat nuk cenon kufizimet dhe përjashtimet e tjera për personat me aftësi të kufizuara të parashikuara nga ligji kombëtar.

Neni 13

Asambleja

1. a) Palët Kontraktuese do të kenë një Asamble.

b) Çdo Palë Kontraktuese do të përfaqësohet në Asamble nga një delegat/përfaqësues, i cili mund të ndihmohet nga delegatë/përfaqësues alternativë, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e secilit delegacion do të mbulohen nga Pala Kontraktuese që e ka emëruar delegacionin. Asambleja mund t'i kërkojë WIPO-së të japë ndihmë financiare për të lehtësuar pjesëmarrjen e delegacioneve të Palëve Kontraktuese, që konsiderohen vende në zhvillim, në përputhje me praktikën e vendosur të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ose që janë vende në tranzicion drejt një ekonomie tregu.

2. a) Asambleja do të trajtojë çështjet që lidhen me mbajtjen dhe zhvillimin e këtij Traktati dhe zbatimin dhe funksionimin e këtij Traktati.

b) Asambleja do të kryejë funksionin që i është caktuar sipas nenit 15, në lidhje me pranimin e organizatave të caktuara ndërqeveritare për t'u bërë palë në këtë Traktat.

c) Asambleja do të vendosë thirrjen e çdo konference diplomatike për rishikimin e këtij Traktati dhe do t'i japë udhëzimet e nevojshme drejtorit të përgjithshëm të WIPO-s për përgatitjen e një konference të tillë diplomatike.

3. a) Çdo Palë Kontraktuese që është Shtet, do të ketë një votë dhe do të votojë vetëm në emrin e vet.

b) Çdo Palë Kontraktuese që është organizatë ndërqeveritare, mund të marrë pjesë në votim në vend të Shteteve të saj Anëtare, me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të saj Anëtare që janë palë në këtë Traktat. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim, nëse ndonjë nga Shtetet e saj Anëtare ushtron të drejtën për të votuar dhe anasjelltas.

4. Asambleja mblidhet me thirrjen nga drejtori i përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend me Asamblenë e Përgjithshme të WIPO-s.

5. Asambleja do të përpiqet të marrë vendimet e saj me konsensus dhe do të krijojë rregullat e veta të procedurës, duke përfshirë thirrjen e seancave të jashtëzakonshme, kërkesat e kuorumit dhe, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati, shumicën e kërkuar për lloje të ndryshme vendimesh.

Neni 14

Byroja Ndërkombëtare

Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s do të kryejë detyrat administrative që lidhen me këtë Traktat.

Neni 15

E drejta për t'u bërë palë në Traktat

1. Çdo Shtet Anëtar i WIPO-s mund të bëhet palë në këtë Traktat.

2. Asambleja mund të vendosë të pranojë çdo organizatë ndërqeveritare që të bëhet palë në këtë Traktat, e cila deklaron se është kompetente në lidhje me çështjet e mbuluara nga ky Traktat dhe ka legjislacionin e vet të detyrueshëm për të gjitha Shtetet e tij Anëtare mbi to, dhe se është autorizuar sipas rregullave, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, për t'u bërë palë në këtë Traktat.

3. Bashkimi Evropian, pasi ka bërë deklaratën e përmendur në paragrafin pararendës në Konferencën Diplomatike që ka miratuar këtë Traktat, mund të bëhet palë në këtë Traktat.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet sipas Traktatit

Në bazë të ndonjë dispozite specifike për të kundërtën në këtë Traktat, secila Palë Kontraktuese gëzon të gjitha të drejtat dhe ndërmerr të gjitha detyrimet sipas këtij Traktati.

Neni 17

Nënshkrimi i Traktatit

Ky Traktat do të jetë i hapur për nënshkrim në Konferencën Diplomatike në Marrakesh dhe më pas në selinë e WIPO-s nga çdo palë e pranueshme për një vit pas miratimit të tij.

Neni 18

Hyrja në fuqi e Traktatit

Ky Traktat do të hyjë në fuqi tre muaj pasi 20 palët e pranueshme të përmendura në nenin 15 të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 19

Data e hyrjes në fuqi e anëtarësimit në Traktat

Ky Traktat do të vendosë detyrim ligjor, për:

- a) 20 palët e pranueshme të përmendura në nenin 18, nga data kur ky Traktat ka hyrë në fuqi;
- b) çdo palë tjetër të pranueshme të përmendur në nenin 15, nga skadimi i tre muajve nga data kur ka depozituar instrumentin e saj të ratifikimit ose aderimit te drejtori i përgjithshëm i WIPO-s.

Neni 20

Denoncimi i Traktatit

Ky Traktat mund të denoncohet nga çdo Palë Kontraktuese me anë të një njoftimi drejtuar drejtorit të përgjithshëm të WIPO-s. Çdo denoncim hyn në fuqi një vit nga data kur drejtori i përgjithshëm i WIPO-s ka marrë njoftimin.

Neni 21

Gjuhët e Traktatit

1. Ky Traktat është nënshkruar në një origjinal të vetëm në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, versionet në të gjitha këto gjuhë janë njësoj autentike.

2. Një tekst zyrtar në çdo gjuhë tjetër, përveç atyre të përmendura në nenin 21(1), do të hartohet nga drejtori i përgjithshëm i WIPO-s me kërkesë të një pale të interesuar, pas konsultimit me të gjitha palët e interesuara. Për qëllimet e këtij paragrafi, "palë e interesuar" do të thotë çdo Shtet Anëtar i WIPO-s, gjuha zyrtare e të cilit ose një nga gjuhët zyrtare të të cilit është e përfshirë, dhe Bashkimi Evropian dhe çdo organizatë tjetër ndërqeveritare, që mund të bëhet palë në këtë Traktat, nëse është përfshirë një nga gjuhët e saj zyrtare.

Neni 22

Depozitari

Drejtori i përgjithshëm i WIPO-s është depozitari i këtij Traktati.

Bërë në Marrakesh, më 27 qershor 2013.

[Fundi i dokumentit]